



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GJIROKASTËR

Nr \_\_\_\_\_ Prot  
\_\_\_\_/\_\_\_\_/2018

Gjirokastër më

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 23.08.2018

Për: “BOE “NG STRUCTURES” shpk me NIPT L79326502O & “ARKONSTUDIO” shpk me NIPT L42019004I & “Shendelli”shpk me NIPT K07924803N me adrese:Lagjia “Selam Musai”, Tepelene.

Procedura e prokurimit: **Tender i hapur punet**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-75900-06-21-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës:“**Rikonstruksioni I Shkollës “Asim Zeneli” +Sistemimi I Jashtëm ( Loti I + Lotii )**” Nga momenti I nënshkrimit të kontratës deri në mbarimin e punes/kryerjen e shërbimit/dorëzimin e mallit sipas grafikut të punimeve (90 dite kalendarike )

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike date 25.06.2018 Nr:25

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **PO** oferta ekonomikisht më e favorshme

**Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. **BOE “MANE/S” shpk me NIPT J64103865K & “BE – IS”shpk me NIPT K71412003A me kontrate bashkepunimi nr.3030 rep,nr.548 kol, date 23.07.2018 perfaqesuar nga Z.Malo MANE perfaqesues ligjor i shoqerise “MANE/S” shpk me prokure te posacme**

Nr.3031 rep, nr.549 kol, date 23.07.2018. Vlera e ofruar e ofertes eshte: 0 (zero) leke

2. Operatori ekonomik OE: “HALILI 1” shpk me NIPT K19303613F.

Vlera e ofruar e ofertes eshte: **69 526 685** (gjashtëdhjetë e nënte milion e pesëqind e njëzet e gjashtëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) **leke pa tvsh** dhe me nje vlere te pergjitheshme **83 432 022** (tetëdhjetë e tre milion e katerqind e tridhjetë e dy mijë e njëzet e dy) **leke me tvsh**

3. BOE “NG STRUCTURES” shpk me NIPT L79326502O & “ARKONSTUDIO” shpk me NIPT L42019004I & “Shendelli”shpk me NIPT K07924803N **me kontrate bashkepunimi nr.1589 rep,nr.595 kol, date 23.07.2018 perfaqesuar nga Z.Fatjon HOXHA perfaqesues ligjor i shoqerise “NG STRUCTURES” shpk me prokure te posacme Nr.1588 rep, nr594 kol, date 23.07.2018.**Vlera e ofruar e ofertes eshte: **69 412 669** (gjashtëdhjetë e nëntë milion e katërqind e dymbëdhjetëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) **leke pa tvsh** dhe me vlere te pergjitheshme **83 295 202.8** (tetëdhjetë e tre milion e dyqind e nentëdhjetë e pese mijë e dyqind e dy presje tete) **leke me tvsh**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE “MANE/S” shpk me NIPT J64103865K & “BE – IS”shpk me NIPT K71412003A

2. Operatori ekonomik OE: “HALILI 1” shpk me NIPT K19303613F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. **Bashkimi i operatoreve ekonomike BOE “MANE/S” shpk me NIPT J64103865K & “BE – IS”shpk me NIPT K71412003A** nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumentave administrative-ligjor teknike, ekonomike e financiare te paraqitura rezultoi se ky BOE kishte mangesi dhe nuk i plotesonte te gjithë kriteret e pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit te percaktuara ne DST, konkretisht si me poshte:

a) Oferta Ekonomike nuk është e rregullt, kjo për shkak se preventivi ofertues, është me gabime, i parregullt dhe jo sipas preventivit ofertues të ngarkuar në sistem. Si e tillë, nuk mund të konkludohej me vlerën e ofertuar.

b) Indeksi i analizës teknike është i ndryshëm nga ai i preventivit ofertues të ngarkuar në sistem.

c) Përshkrimi i zërave të punimeve është me gabime kuptimore dhe sasiore.

d) Ka mospërputhje të njërive matëse të preventivit ofertues të BOE me preventivin ofertues të ngarkuar në sistem, çka ndikon direkt në volume sasiore pune, kusht bazik dhe themelor për vlerësimin e ofertës ekonomike, dhe njëkohësisht në kundërshtim me: Nenin 14 “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët

e) 1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, si dhe veprimet që ndalohen me ligj. Në to shpjegohet se pjesëmarrësit në procedurën e prokurimit duhet të përdorin vetëm dokumentet standarde të tenderit, pa

- bërë asnjë ndryshim*”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, ne zbatim te ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.
- f) Nuk ka plotësuar kriterin teknik në lidhje me stafin e drejtuesve teknikë nëlicencën profesionale sipas pikës 2.3.3 të Dokumenteve Standarte të Tenderit për kapacitetin teknik, ku kërkoheshin dy Arkitektë, kriter ky i cili mjafton të plotësohet nga njëri ose nga bashkimi i operatorëve.
- g) Ky BOE ka vetëm një drejtues teknik Arkitekt nëlicencën profesionale, por të padeklaruar si prezent në kantier në shtojcat e DST.

**Specifikisht:**

**Operatori ekonomik MANE/S:**

- h) - Ka drejtues teknik Arkitekt nëlicencën profesionale, por nuk e ka deklaruar në shtojcat e deklaratave të stafit teknik.

**Operatori ekonomik BE-IS:**

- i) - Nëlicencën profesionale nuk figuron asnjë drejtues teknik me profesion Arkitekt. Operatori ekonomik ka paraqitur një kontratë pune me një Arkitekt i cili figuron mbikëqyrës punimesh në regjistrat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në kundërshtim me legjislacionin konkretisht:

Neni 18 “Kufizime për tërheqjen dhe përdorimin e licencave”, Pika 6. “Personat të cilët janë të pajisur me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, të cilët punësohen pranë shoqërive për zbatim të punimeve të ndërtimit, duhet të dorëzojnë kopjen origjinale të licencës së mbikëqyrjes dhe kolaudimit, pranë arkivës së Sekretariatit Teknik. Kjo licencë i kthehet përsëri personit, në momentin që ai shkëputet nga pozicioni i drejtuesit teknik, në shoqërinë për zbatimin në ndërtim”, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 943, datë 28.12.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” sipas të cilit një mbikëqyrës punimesh nuk mund të kryejë rolin e drejtuesit teknik të punimeve të zbatimit.

**Ky BOE skualifikohet.**

2. Operatori ekonomik OE: “**HALILI 1**” shpk me NIPT K19303613F. Vlera e ofruar e ofertes është: 57 938 904 (pesedhjetë e shtatë milion e nentëqind e tridhjetë e tete mijë e nentëqind e kater) leke pa tvsh dhe me vlerë të përgjithshme 69 526 685 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e njëzet e gjashtëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) leke me tvsh, nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumentave administrative-ligjor teknike, ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik nuk ka dorëzuar dokumentet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, ky operator ekonomik **skualifikohet.**

\* \* \*

4. Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e operatoreve ekonomike BOE “NG STRUCTURES” shpk & “ARKONSTUDIO” shpk & “Shendelli”shpk** me adrese: Lagjia “Selam Musai”, Tepelene, se oferta e paraqitur, me vlerë **69 412 669** (*gjashtëdhjetë e nëntë milion e katërqind e dymbëdhjetëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë*) **leke pa tvsh** dhe me vlere te pergjitheshme **83 295 202.8** (*tetëdhjete e tre milion e dyqind e nentëdhjete e pese mije e dyqind e dy presje tete*) **leke me tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Gjirokaster sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.08.2018

Ankesa: ka ose jo **Nuk ka patur ankesa.**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

\* \* \*

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Zamira RAMI**